



## Shkolla dhe transporti ekuivalent

*Informatë për transportin shkollor të nxënësve që banojnë në lagjet Frälsegården ose Kronogården dhe vijnë në shkollën fillore.*

Kjo informatë është për ju që jeni kujdestar i një nxënësi të shkollës fillore i cili banon në Kronogården ose Frälsegården në Trollhättan. Këtu mund të mësoni se çka është transporti shkollor dhe se cilët nxënës mund të udhëtojnë me të. Këtu gjeni edhe përgjigjet në pyetjet me të zakonshme për transportin shkollor.



Trollhättans Stad ka vendosur për mbylljen e ciklit të mesëm dhe të lartë në shkollën Kronan dhe tërë shkollën Frälsegårsskolan me fillim nga vera 2021. Nga vjeshta nxënësit do të fillojnë të shkojnë në shkollat e tyre të reja dhe mund të kenë të drejtën e udhëtimit me transportin shkollor deri në ato shkolla.

### **Çka është transporti shkollor?**

Transporti shkollor ju lejonet nxënësve që duhet të udhëtojnë goxha larg mes shtëpisë dhe shkollës ku janë caktuar. Orari i qarkullimit të transportit shkollor i përshtatet fillimit dhe mbarimit të mësimin në shkollë. Nxënësit që banojnë në Kronogården ose në Frälsegården hipin në autobusin e shkollës në vendndalimin afër shkollës Kronans skolan në mëngjes. Autobusi i transporton nxënësit deri në shkollën e re. Pas mbarimit të orarit mësimor autobusi i merr nxënësit në shkollë dhe i transporton ata deri te vendndalimi afër shkollës Kronans skola. Ka edhe nxënës që udhëtojnë me taksi shkollorë dhe autobusë special. Udhëtimi me transportin shkollor është falas.

### **Kush mund të udhëtoi me transportin shkollor?**

Vendimi se cilët nxënës mund të udhëtojnë me transportin shkollor mirret në bazë të Ligjit për shkollën dhe në bazë të rregullave të qytetit Trollhättan. E drejta për transportin shkollor fitohet varësisht nga vendi se ku banoni dhe në cilën shkollë shkoni.

- **Nxënësit që banojnë në Kronogården ose në Frälsegården dhe shkojnë në klasat 3-6 në Frälsegårsskolan osen ë klasat 3-8 në Kronan:** Nëse nxënësit i është caktuar shkolla e re në njërin nga shkollat Lyrfågelskolan, Stavreskolan, Strömslundsskolan, Paradisskolan ose



april 2021

Skogshöjdens skola atëherë ai nxënës ka të drejtën e transportit shkollor. Ju nuk keni nevojë të plotësoni ndonjë blanketë kërkesë.

- **Nxënësit që banojnë në Kronogården ose në Frälsegården dhe qysh tani vijnë në mësimin në Strömslundsskolan, Paradisskolan ose në Skogshöjdens skola:** Nxënësit kanë të drejtën e transportit shkollor. Ju nuk keni nevojë të plotësoni një blanketë kërkesë.
- **Nxënësit që banojnë në Kronogården ose në Frälsegården dhe qysh tani vijnë në mësimin në Lyrfågelskolan ose në Stavreskolan:** Nxënësit kanë të drejtën e transportit shkollor por ju duhet ta plotësoni një blanketë kërkesë të cilin e merrni nga mentori i nxënësit.



april 2021

### **Vetëm nxënësit mund të udhëtojnë me autobusin e shkollës**

Autobusi i shkollës është vetëm për nxënësit që shkojnë në shkollë dhe të cilët kanë të drejtën e transportit shkollor. Shoferi i autobusit ka listën me nxënës që mund të udhëtojnë me autobus. Shokët apo vëllëzrit/motrat që nuk e kanë të drejtë e udhëtimit me transportin shkollor nuk mund të udhëtojnë me autobusin e shkollës.

### **Një udhëtim i sigurtë vajtje ardhje nga shkolla**


Është me rëndësi që nxënësit të ndihen të sigurtë në autobus. Prandaj do kemi personel prezent nga dita e parë e shkollës me 18 gusht dhe për disa javë radhazi. Personeli do udhëtoi bashkë me nxënësit në autobus dhe do të kujdeset që të gjithë të ndihen të sigurtë. Personeli do ndihmoi nxënësit që të gjinden si dhe ku duhet në shkollë pas arritjes me autobus.

### **Eja me kohë te autobusi**

Është me rëndësi që të vini me kohë tek vendndalimi i autobusit. Nëse nuk e arrini autobusin e shkollës me kohë atëherë duhet të shkoni në shkollë në një mënyrë tjetër. Gjithashtu është me rëndësi që të hipni në autobusin tuaj. Autobus të ndryshëm nisen nga vendndalimi tek Kronan çdo mëngjes. Orari i qarkullimit të autobusit është përshtatur në atë mënyrë që të gjithë nxënësit të arrijnë në shkollë para fillimit të mësimt. Në të njëjtën mënyrë autobusi qarkullon edhe pas mbarimit të mësimt, ashtu që nxënësit të kthehen në shtëpi me kohë. Prandaj autobusi nuk e pret askend që vonohet.

### **Është me rëndësi të hipni në autobusin tuaj**

Autobusët udhëtojnë për në shkolla të ndryshme, dhe ju mund të shkoni në shkollën e gabuar nëse hipni në një autobus tjetër. Nëse gjatë udhëtimit e zbulon se gjëndesh në autobusin e gabuar bisedo menjëherë me shoferin. Shoferi të ndihmon të kontaktosh me arsimtar ose një të rritur tjetër në shkollë i cili do të ndihmoj.



### **Autobusi i shkollës ndalet afër Kronan**

Ende nuk caktuar orari i saktë për nisjen e autobusit në mëngjes dhe për ardhjen pasdite. Orari i udhëtimit bëhet gati në fillim të korrikut. Por është vendosur që vendndalimi i autobusit të jetë tek shkolla Kronan skola. Nga aty do të nisen të gjithë nxënësit në mëngjes dhe po aty do të kthehen me autobus pas mbarimit të ditës në shkollë.

### **Vendndalimi i autobusit**




**Trollhättans  
Stad**

*Utbildningsförvaltningen*

*april 2021*

Në hartë mund të shihni shkollën Kronans skola dhe vendndalimin e autobusit shkollor të shënuar me një simbol.

**Hållplats** 



april 2021

### **Me shumë informata për transportin shkollor**

Do ju japi më shumë informata për transportin shkollor në fillim të korrikut. Planifikimi i transportit shkollor do jetë gati atëherë dhe ju do e merrni me postë orarin e udhëtimit me autobusin e shkollës. Në orarin e udhëtimit shkruan se me cilin autobus do udhëtoj fëmiu i juaj, ku është vendndalimi, dhe ora e saktë e nisjes në mëngjes dhe e ardhjes pasdite.

Ju mund të lexoni më shumë për transportin shkollor në faqen e internetit të Trollhättans Stad: [www.trollhattan.se/skolskjuts](http://www.trollhattan.se/skolskjuts)

Në faqën e internetit mund ta merrni blanketëkërkesën për transport shkollor nëse fëmiu i juaj banon në dy adresa të ndryshme, apo nëse ju keni zgjedhur një shkollë tjetër në vend të asaj që ju është caktuar. Ju gjithashtu mund ti shkarkoni rregullat për transportin shkollor në Trollhättan.



Nxënësit që banojnë në Kronogården ose në Frälsegården dhe të cilët qysh tani vijojejnë mësimin në Stavreskolan, Lyrfågelskolan, Paradisskolan, Strömlunsskolan ose në Skoghöjdens skola, me 12 prill do të marrin informatat dhe blanketën për të kërkuar transportin shkollor nga shkolla e tyre përkatëse